



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" Durrës

Nr. 320 Prot.

Durrës, më 03.08.2026

**Lënda:** Njoftim për levizje paralele.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" Durrës

Rruga "Bulevardi Bajram Curri", Tiranë

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela" ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin/pozicionet:

- Pozicioni: - 1 (Një) Mësues i teorisë profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizëm (zëvendësues leje lindje)

#### 1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

1. **Kritere të përgjithshme:** a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë

shuar; e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

## **2. Kriteret të posaçme për mësues të teorisë profesionale:**

a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së; b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit; d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

## **2. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a) letërmotivimin për pozicionin; b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 11 të këtij udhëzimi; c) kartën e identitetit; d) diplomën; e) librezën e punës; f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV; g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h) vërtetimi të gjendjes shëndetësore; i) vërtetim të gjendjes gjyqësore; j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi; k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit në Shkollën e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", brenda afatit 11.08.2026 të aplikimit të përcaktuar në shpallje.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

**DREJTORE**

**Dr. Blerina DERVISHI**

